

20210711062

BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të nenit 25 paragrafi 1 dhe 3 dhe 47 paragrafi 1 pika 20 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi

VENDIM PËR LËSHIM NË QARKULLIM TË MONEDHAVE ME VLERË NOMINALE 1 DENAR ME KARAKTERISTIKA TË NDRYSHUARA

1. Me këtë vendim lëshohen në qarkullim monedhat me vlerë nominale 1 denar me shenjë të emetimit "2020" dhe me karakteristikat e parapara në Vendimin për emetimin dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 1 denar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15) dhe Vendimin për emetimin e monedhave me vlerë nominale 1 denar me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 181/19), duke filluar nga data 1 prill i vitit 2021.

2. Me lëshimin në qarkullim të monedhave nga pika 1 e këtij vendimi, paralelisht në qarkullim në operacionet me para të gatshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut do të jenë edhe monedhat me vlerë nominale 1 denar, të emetuara në bazë të Vendimit për emetim dhe karakteristikat themelore të monedhave me vlerë nominale 1 denarë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 223/15) dhe Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të monedhave dhe kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 25/93).

3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr.V. 02-15/IV-1/2021
26 mars viti 2021
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së Veriut
D-r. Anita Angelovska-Bezhoska